



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 11/2015

Prishtinë, më 10.3.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Visar Ymeri, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca, Pal Lekaj, Enver Hoti dhe Duda Balje anëtare.

Mungoi: Sasha Milosavleviq, anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati-ZPRK; Ramadan Sejdiu, Alban Çollaku dhe Flutura Shala-MZHE; Dardan Abazi – INDEP, Avni Bytyçi – GLPS, Lejla Selimi – OSBE, Visar Rushiti dhe Berat Thaçi - GAP; Valmire Hoti dhe Qëndrim Imeri - Infodirekt.TV; Marko Zakiq; - RTK2; Sylejman Blaku – Kosova Sot; Ilir Krasniqi - Kosova Info; Elton Bellopoja – NDI (praktikant), Besa Berisha – UNDP (praktikante).

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetari i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 3.3.2015;
3. Shqyrtimi i Raportit me Amendamente i Projektligjit Nr.05/L-09 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 3.3.2015;

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 3.3.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me Amendamente i Projektligjit Nr.05/L-09 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike;

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha se pasi që Komisioni ka organizuar dëgjim publik më të gjitha palët e interesit, ka marrë për bazë të gjitha sugjerimet e deputeteve nga leximi i parë në seancë plenare, grupi i punës ka mbajtur dy takime, ku ka shqyrtuar shumë propozime të grupeve parlamentare dhe të ekspertëve, pastaj i ka nxjerr disa amendamente në projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe pastaj ka ndërhyrë edhe në ligjin bazik për ndërmarrjet publike, pasi që është konsultuar me qeverinë. Pastaj paraqiti dhe i arsyetoi amendamentet një nga një, si ne vijim:

Amendamenti 1 - Titulli i Projektligjit ndryshohet ashtu që në fund të tekstit i shtohet fjalia ”i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111”.

Pra në këtë nen është bërë një ndryshim i ligjit sepse Ligji për ndërmarrjet publike është ndryshuar edhe njëherë në vitin 2011, nga Kuvendi, andaj me këtë amendament e kemi plotësuar titullin e projektligjit.

Amendamenti 1 njëzëri u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 2 - Neni 3 i Projektligjit, fshihet pjesa e dytë e paragrafit 11.3 të Ligjit bazik. Kjo është pika që ka qenë më së shumti e diskutuar, ku bëhet fjalë për komunat dhe për këtë pikë kemi pasur dy propozime: një ka qenë që të fshihet dhe njëri që të riformulohet. Grupi i punës e ka parë të arsyeshme propozimin që të fshihet pjesa e dytë e paragrafit 11.3, sepse komunat kanë të drejtën edhe me ligjin në fuqi që të propozojnë themelimin e ndërmarrjeve publike, në bazë të një arsyeshmërie të plotë dhe e kemi parë të panevojshëm këtë pikë, prandaj edhe e kemi fshi.

Amendamenti 2 njëzëri u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 3 - Neni 3 i Projektligjit, nënparagrafit 11.4 të Ligjit bazik, i shtohet teksti: “do të konsiderohen si pjesë e Ndërmarrjes Publike.”

Ky nen vetëm është harmonizuar me tekstin në gjuhën angleze sepse në gjuhën shqipe ka qenë i mangët.

Raif Qela tha se nënparagrafi 11.4 duhet të qartësohet dhe ai ka edhe gabime drejtshkrimore.

Kryetari tha se me këtë amendament qartësohet kjo dispozitë, kurse shtoi se e pranon vërejtjen e deputetit Qela, që ka gabime gjuhësore dhe për gabime gjuhësore apo drejtshkrimore do rregullohet para leximit të dytë nga stafi i Komisionit apo lektorët.

Amendamenti 3 njëzëri u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 4 - Neni 4 i projektligjit, fjalia ”me akt normativ të veçantë“, zëvendësohet me ”akt të veçantë ligjor“.

Po ashtu edhe ky amendament është një rregullim teknik sepse në mënyrën si ka qenë në projektligj, krijonte paqartësi dhe keqinterpretim.

Amendamenti 4 njëzëri u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 5 - dy propozime

Neni 5 i Projektligjit, nenit 37 A, tekstit të këtij neni në fillim i shtohet: “Duke u nisur nga interesi i veçantë dhe rëndësia e saj”.

Kryetari tha se në këtë nen e kemi shtuar vetëm një fjali, për shkak të rëndësisë që ka ndërmarrja “TREPÇA” për vendin dhe për shoqërinë në përgjithësi, ndërsa më miratimin e këtij ligji obligohet Qeveria që të bëjë një studim të fizibilitetit, të hartojë një strategji dhe mandej të nxjerrim një ligj të veçantë për “TREPÇEN”.

Visar Ymeri paraqiti amendamentin nga Grupi Parlamentar LVV-së si në vijim:

Neni 5 i projektligjit, përkritazi me shtimin e Nenit 37A, teksti i propozimit sipas këtij neni të ndryshohet me tekstin si në vijim:

Neni 37A Ndërmarrja e regjistruar në regjistrat gjyqësor me emërtimin: Kombinati Xehetar Metalurgjik Kimik “Trepça”, e cila aktualisht e bazuar në certifikatën e biznesit identifikohet me emërtimin “Trepça” në administrimin e AKP-së”, do të shndërrohet në ndërmarrje publike e veçantë dhe do të rregullohet me strategji dhe Ligj të veçantë. Deri në miratimin e këtyre akteve, kjo ndërmarrje do të vazhdojë të afarojë në kushtet aktuale, duke përfshirë edhe moratoriumin, në pajtim me Ligjin mbi riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre.

Ymeri duke e arsyetuar amendamentin, tha se meqenëse qëllimi i këtij projektligji është që të rregullohet mundësia ligjore për transformimin e statusit të ndërmarrjeve shoqërore në ato publike, dispozita në fjalë do të ishte e nevojshme për sqarimin e ndryshimit të statusit të ndërmarrjes “Trepça”, si ndërmarrje e cila ka statusin e ndërmarrjes shoqërore e që administrohet nga AKP-ja. Edhe pse sponsoruesi i projektligjit ka përmendur nxjerrjen e një ligji dhe strategjie të veçantë përkritazi me ndërmarrjen “Trepça”, garantimi dhe vënia e bazës së rregullimit juridiko-ligjor, që pasuria dhe asetet e kësaj ndërmarrje të jenë në pronësi publike është kërkesë parësore që duhet ta përfshijë ky ligj. Përcaktimi i statusit të ndërmarrjes “Trepça” si ndërmarrje publike, statusi i së cilës rregullohet me akt të veçantë ligjor dhe po ashtu dokument të veçantë strategjikë, bënë definimin dhe kualifikimin ligjor në raport me rregullimin e përgjithshëm ligjor për ndërmarrje publike.

Besim Beqaj, theksoi së nuk është mirë që të hapet ky debat tani në kuadër të ligjit për ndërmarrjet publike, pasi që projektligji në fjalë e parasheh që të hartohet një ligj i veçantë vetëm për “Trepçën” dhe në kohën kur të vjen ligji, do të diskutojmë e jo tani.

Fatmir Rexhepi për nenin 37 A, tha që zgjedhja do të ishte më lehtë pasi ta kemi një strategji, analizë dhe vlerësim më të detajuar për “Trepçën”, pastaj ta gjejmë metodën më të mirë të organizimit për gjithë kompleksin “Trepça”.

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha përderisa nuk e kemi një studim të fizibilitetit dhe strategji për “Trepçën”, atëherë ky propozim është e panevojshëm. Andaj, studimin e fizibilitetit dhe strategjinë për “Trepçën” duhet t’i vendosim si prioritet nacional dhe mandej jemi ne deputetët e këtij Kuvendi që do ta nxjerrim ligjin e veçantë për “Trepçën” dhe do të vendosim së çfarë statusi do të këtë.

Pas debatit, me tri (3) vota Për, gjashtë (6) vota Kundër dhe një (1) Abstenim nuk kaloi propozim i GP i LVV-së ndërsa kaloi propozimi i Komisionit.

Amendamenti 6 - Neni 5 i Projektligjit, fshihet Neni 37B.

Ky nen është vlerësuar si i pa arsyeshëm dhe i panevojshëm për shkak se edhe si i tillë ndërhyr në fushën e gjyqësorit dhe tanimë e kemi të rregulluar me ligjin tjetër çështjen e likuidimit dhe riorganizimit të ndërmarrjeve.

Amendamenti 6 njëzëri u përkrah nga Komisioni.

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, theksoi së grupi i punës është pajtuar që të ndryshojë edhe disa nene në ligjin bazik për ndërmarrjet publike. Ai tha se duke u nisur nga Rekomandimet e Kuvendit të Kosovës, me rastin e shqyrtimit të Raportit mbi zbatimin e Ligjit mbi ndërmarrjet publike, të aprovuara në seancën e mbajtur më 12.12.2013, si dhe nga diskutimet në lexim të parë në Kuvendin e Kosovës më 13.2.2015, nga diskutimet paraprake në Komision si dhe pëlqimi parimor i përfaqësuesit të Qeverisë më datën 3.2.2015, duke u nisur edhe nga sugjerimet e dhëna gjatë dëgjimit publik të datës 27.2.2015, Komisioni propozon edhe dy amendamente në ligjin bazik, që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e Bordeve të NP-ve dhe raportin e tyre me perceptimet e konsumatorëve mbi cilësinë e shërbimeve.

Besim Beqaj tha se nuk është mirë që keni ndërhyrë në ligjin bazik dhe kjo është kundër procedurave sepse edhe Komisioni për legjislacion do të kthejë prapa propozimet. Ne si deputetë e kemi në shqyrtim projektligjin dhe nuk e kemi ligjin sepse ndoshta edhe ne të tjerët do të kishim propozimet tona. Pra, e ndaj mendimin për ndërhyrje në ligjin bazik për shkaqe procedurale, tha Beqaj.

Fatmir Rexhepi tha se është e vërtetë se ne e kemi para vetës projektligjin, por jemi pajtuar në parim që të kemi ndërhyrje vetëm në dy çështje; në atë të performancës së Bordeve dhe të cilësisë së shërbimeve që ofrojnë këto ndërmarrje publike.

Kryetari tha se gjatë gjithë kohës sa e kemi këtë projektligj, kemi thënë së do të ndërhyjmë në këto dy çështje që i potencoi edhe z.Fatmir Rexhepi, në çështjen e përgjegjësisë së Bordeve të NP-ve, pra të performancës dhe raportin e tyre me perceptimet e konsumatorëve, për cilësinë e shërbimeve që i ofrohen konsumatorëve.

Amendamenti 7 - 1. Neni 7, paragrafi 2 i Ligjit bazik ndryshohet si në vijim:

7.2. Aksionari(ët) do të kërkojë nga Bordi i Drejtorëve që ta përgatisë dhe t'ia dorëzojë aksionari(ëve) një raport mbi arsyet në rast se: i. Performanca e NP-ve devijon nga caqet e përcaktuara në Planin e Biznesit nga Bordi i Drejtorëve për vitin përkatës financiar;

ii. Vlera e aseteve të NP-ve zvogëlohet;

iii. Bie niveli i kënaqësisë së konsumatorëve në lidhje me cilësinë e shërbimeve. Në këto raste aksionari(ët) do të marrë parasysh masa të nevojshme korrigjuese.

2. Neni 7, paragrafi 3 i Ligjit bazik në rreshtin e parë, fjalja "në arritjen e caceve të saj të performancës", zëvendësohet me "në kuptim të paragrafit 7.2 të këtij neni".

Fatmir Rexhepi, kërkoi që të saktësohet më shumë amendamenti, kur fjala të aksionarët dhe vlerësimi, pasi që duhet të gjendet një metodë e matjes së performancës dhe e vlerësimeve.

Raif Qela tha se ky amendament duhet të përmirësohet, që të jetë më i qartë. Ai propozoi që fjalja "mbi arsyet" të zëvendësohet me fjalinë "të hollësishëm" dhe pas fjalisë "Plani i Biznesit" të shtohet fjala "të miratuar" si dhe të përmirësohen disa gabime gjuhësore në këtë paragraf.

Amendamenti 7, njëzëri u përkrah nga Komisioni me propozimet e deputetit Raif Qela.

Visar Ymeri paraqiti propozim amendamentet nga GP i LVV-së si në vijim:

Amendamenti 8

Neni 9 të ligjit bazik, i shtohet paragrafi me numër rendor 9.2, me tekstin si në vijim:

9.2: Shitja e aksioneve të ndërmarrjeve nga Neni 11.3 të këtij Ligji mund të tjetërsohen vetëm pasi që vendimi i miratuar i Qeverisë të jetë votuar nga Kuvendi i Kosovës me 2/3 e votave të të gjithë deputeteve të Kuvendit.

Ymeri në arsyetimin e amendamentit, tha se është në interesin vital të Republikës së Kosovës që vendimet në lidhje me shitjen e aksioneve të ndërmarrjeve shoqërore, të cilave iu ndryshohet statusi në ndërmarrje publike, të jenë në kontrollin parlamentar, sipas një kriteri me karakter rigoroz. Kjo sidomos, kur kemi të bëjmë me ndërmarrjet që kanë rëndësinë strategjike për ekonominë dhe interesat e Republikës së Kosovës. Në këtë kuptim kontrolli dhe cilësia e autorizimit që do t'i njihet Kuvendit të Kosovës, që këto vendime të Qeverisë të miratohen me një shumicë të cilësuar, do të mbronte asetet që janë në pronësi të Republikës. Andaj futja e këtij neni në këtë projektligj, është i domosdoshëm për të arritur në parim qëllimin e nxjerrjes së këtij ligji.

Besim Beqaj potencoi përsëri se ndërhyrja në ligjin bazik për ndërmarrjet publike, duke hartuar amendamente është e gabueshme, pasi që duhet të bëjmë analiza në ligj para së të fillojmë ta ndryshojmë dhe kjo proceduralisht nuk është në rregull.

Visar Ymeri tha se arsyeja pse është propozuar ky amendament është që të kemi një konsensus më të gjerë politik, lidhur me ndërmarrjet publike në nivel qendror, që janë aset nacional për shtetin, siç janë PTK-ja dhe KEK-u. Prandaj vendimi duhet të jetë më 2/3 e votave të të gjithë deputeteve, e jo vetëm me shumicën e thjeshtë të deputetëve të pranishëm në seancë plenare sepse hipotetizohet nëse në atë seancë plenare i kemi 61 deputetë, me 32 deputet mund të vendoset për një aset vital të vendit.

Fatmir Rexhepi tha që është arsyeshme kjo të bëhet, por si ta bëjmë këtë dallim që për çdo privatizim për ndërmarrjet me projekt nacional, duhet të jenë 2/3 e votave. Mirëpo, në parim tha që është pro këtij amendamenti.

Enver Hoti duke iu referuar amendamentit, tha që e mbështet propozimin, pasi që për çështje të projekteve nacionale duhet të ketë një konsensus politik më të madh në vendimmarrje.

Kryetari Komisionit Muhamet Mustafa theksoi se kjo është një çështje e rëndësishme se veçante dhe se kërkon më shumë debat paraprak me akteret e interesuar, andaj propozoj që mos të merret në konsiderim me këto ndryshime por të adresohet me ligjin e ri për ndërmarrjet publike.

Pas debatit, më gjashtë (6) vota Për, tri (3) Kundër dhe një (1) Abstenim, Komisioni miratoi Amendamentin 8, propozim i GP të LVV-së.

Sala Berisha-Shala, propozoi 2 amendamente si në vijim:

Amendamenti 1

Neni 17.4, të shtohet një paragraf 17.A “Çdo Bord të drejtorëve të ndërmarrjeve publike të ketë së paku një drejtor të gjinisë femërore, që i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 17, të këtij ligji.

Amendamenti 2

Neni 20.4, Njësia për monitorimin e ndërmarrjeve publike, në mes të vitit të përgatisë dhe të bëjë publike, një deklaratë transparente, një deklaratë për politikën e kompensimit për drejtorët dhe zyrtarët e lartë NP-ve.

Sala Berisha – Shala në arsyetimin e amendamenteve, tha se kemi bërë një lloj konsensusi me sugjerimet që kanë dalë për projektligjin për ndërmarrjet publike, nga dëgjimi publik, leximi i

parë në seance dhe më rekomandimet nga monitorimi i ligjit për ndërmarrjet publike, andaj tha kjo i ka propozuar këto dy amendamente.

Pal Lekaj për amendamentin 1, tha se kjo çështje rregullohet edhe me më Ligjin për Barazi Gjinore dhe këtu s'ka nevojë të futet.

Visar Ymeri propozoi që jo vetëm në Borde por në tërë ndërmarrjen 40% e të punësuarve të jenë gjinia femërore, e pastaj kjo të bartet edhe në Borde.

Duda Balje tha se pajtohet me propozimin e deputetes Sala Berisha – Shala, që në Borde të kemi 40% të femrave. Por ashtu, ajo u pajtua edhe me propozimin e deputetit Ymeri, që jo vetëm në Borde, por edhe në tërë ndërmarrjen publike të kemi pjesëmarrje gjinore.

Blerim Grainca për amendamentin 1, të propozuar nga deputetja Sala Berisha – Shala, propozoi që të ndryshohet kështu “të rregullohet në harmoni me Ligjin për barazi gjinore”.

Pas debatit Komisioni e aprovoi Amendamentin 1 të deputetes Sala Berisha-Shala, si Amendament 9, në këtë formë:

Amendamenti 9 - Neni 17.4 të Ligjit bazik i shtohet një nen i ri 17.4A, si ne vijim:

Neni 17.4A: “Përbërja e Bordeve të drejtorëve të NP-ve duhet të jetë në harmoni me Ligjin për barazi gjinore.

Ndërsa, Komisioni nuk e aprovoi Amendamentin 2, të deputetes Sala Berisha-Shala, duke e cilësuar si të panevojshëm.

Amendamenti 10 - Neni 29 i Ligjit bazik, i ndryshuar me Ligjin nr.04/L-111, riformulohet si vijon:

Bordet e NP-ve, njëherë në vit do ta testojnë kënaqësinë e konsumatorëve në bazë të procedurave përkatëse përmes organizatave kredibile të pavarura.

Ky raport i dorëzohet:

(i) Njësisë për Politikën dhe Monitorimin e NP-ve më së largu deri më 31 mars për vitin paraprak, e cila e publikon atë në faqen e saj në internet dhe

(ii) sipas rastit, Qeverisë ose Komisionit(eve) përkatëse Komunale të Aksionarëve.

Kryetari tha që për këtë amendament jemi pajtuar në grupin e punës, që ta nxjerrim, sepse neni 29 i ligjit bazik është mjaftë konfuz dhe me këtë ndërhyrje e kemi qartësuar dhe i kemi dhënë mundësinë që një organizatë e pavarur ta bëjë testimin e kënaqësisë së konsumatorëve për shërbimet që i ofron një ndërmarrje publike.

Blerim Grainca propozoi që fjala “testojmë” të zëvendësohet me fjalën “masin” sepse është më e qartë.

Amendamenti 10 njëzëri u përkrah nga Komisioni me propozimin e deputetit Blerim Grainca.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

1. Miratohet Raporti me Amendamente i Projektligjit nr.05/L-09 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike;

2. Raporti t'i procedohet Komisioneve të përhershme dhe Kuvendit, sipas procedurës për lexim të dytë.

4. Të ndryshme.

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha se për të na njoftuar lidhur me procedimin e raporteve të ndërmarrjeve publike të vitit 2013 dhe 2014, është i pranishëm z.Ramadan Sejdiu, drejtor i Njesisë për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike në kuadër të MZHE- së.

Ramadan Sejdiu, Drejtor i Njesisë për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike, i njoftoi anëtarët e komisionit, lidhur raportin e ndërmarrjeve publike për vitin 2013, që mund t' ia sjellë për të raportuar sepse është i gatshëm, mirëpo, për shkak se ka qenë Kuvendi i shpërndarë s'ka mundur ta procedojë, ndërsa për raportin e vitit 2014, tha se duhet të presim deri në muajin qershor, pasi t' ju behet auditimi.

Ai kërkoi që të raportoj për dy raportet e vitit 2013-2014 përnjëherë.

Kryetari kërkoi që për këtë çështje, pra për mënyrën raportimit duhet të shikohet baza ligjore së a keni të drejtë të raportoni për të dy vitet apo vetëm për njërin vit kalendarik.

Komisioni përkrahu propozimin e Kryetarit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa